



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.15, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 03.07.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Emigracioni Shqiptar

OBJEKT: Kundërshtimi i Vendimit të KZAZ. 51, Gramsh për nxjerrjen e Tabeles Përmbledhese të Rezultateve për kandidatet për Keshillin e Bashkisë Gramsh.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa (b), neni 126, pika 2 dhe neni 130, pika (c), të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Emigracioni Shqiptar ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr. 15 regj. datë 03.07.2019.

Në mbledhjen e datës 05.07.2019 ora 13.00, pas relatimit Znj.Edlira Jorgaqi, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike u konstatua se kjo kërkesë ankimore nuk përmban elementët e



Nr. 1081 i Vendimit Data 11.07.2019 Ora 10:00 e Vendimit

Për mospranimin për Shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.15, datë 03.07.2019 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Emigracioni Shqiptar

formës duke mos plotësuar një nga kërkesat e nenit 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Konkretisht, nuk është plotësuar sipas formatit të përcaktuar, si dhe nuk i është b/lidhur kërkesës ankimore të paraqitur kopja e vendimit të KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve, ndaj të cilit subjekti zgjedhor ankues ka ushtruar ankim në KQZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të nenit 129, pika 3, gërma (c) të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja pasi bëri verifikimin paraprak të kërkesës ankimore, me vendimin me nr. 950 datë 05.07.2019 vendosi kthimin për plotësim të kërkesës ankimore me nr. 15 regj.

Pas marrjes në dorëzim të materialeve plotësuese në mbledhjen e datës 11.07.2019, ora 10:00 pas relatimit të znj. Edlira Jorgaqi, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se ankuesi në datë 10.07.2019 ka dorëzuar plotësimin e kërkesës ankimore me nr. 15 regj. Referuar nenit 129 pika 4, dhe 130 pika (c) të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ankuesi Partia Emigracioni Shqiptar nuk e ka bërë plotësimin e kërkesës dhe ridepozitimim e saj brënda 24 orëve nga çasti i shpalljes së vendimit me nr. 950 datë 05.07.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa (b), neni 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 15, datë 03.07.2019, të paraqitur nga Partia Emigracioni Shqiptar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 1081 i Vendimit Data 11.07.2019 Ora 10:00 e Vendimit

Për mospranimin për Shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.15, datë 03.07.2019 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Emigracioni Shqiptar